



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1017/9 prot.

Tiranë, më 30.12 2025

RAPORT

PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK ME OBJEKT:
***“MBI PRAKTIKËN DHE SHKAQET E ZËVENDËSIMIT TË PROKURORËVE, NË
PROKURORITË PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR, DURRËS DHE VLORË PËR
PERIUDHËN 01.01.2024-31.12.2024”***

I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në zbatim të vendimit nr. 14, datë 01.04.2025 *“Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt:
Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë për periudhën
01.01.2024-31.12.2024”* të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Tiranë, DHJETOR 2025

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit tematik “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”.

Data e përgatitjes:

30.12.2025

Përgatitur nga:

Julian Zonja

Lindita Ziguri

Për shqyrtim nga:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Artur Metani

Miratoi ☐ Ndryshoi ☐ Ktheu ☐

Datë 30. 12. 2025

1. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat "dh", "ë" dhe "k", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025, planin e inspektimeve për vitin 2025.

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 "Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025", është zhvilluar inspektimi tematik me objekt "Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë për periudhën 01.01.2024-31.12.2024".

Për kryerjen e inspektimit sipas vendimit nr. 14, datë 01.04.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u caktuan inspektorët:

- Z. Julian Zonja për prokuroritë si më poshtë:
 - 1- Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
 - 2- Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
- Znj. Lindita Ziguri për prokuroritë si më poshtë:
 - 1- Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
 - 2- Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 147/d, pika 2, e cila parashikon se: "Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë", në ligjin nr. 115/2016

“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neni 204, pika 1, gërma “dh”, e cila parashikon se: “Në zbatim të funksioneve të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron kompetencat e mëposhtme dh): “... miraton planin vjetor të inspektimeve institucionale e tematike”; në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 6, e cila parashikon se: “6. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së prokurorisë lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

Gjithashtu janë administruar edhe:

- Raporti vjetor i veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2024.

Rekomandime nga inspektimi pararendës i së njëjtës natyrë dhe zbatimi i tyre

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka realizuar më herët inspektimin për praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2023-31.12.2023. Këtij inspektimi iu nënshtruan Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Në kushtet kur u inspektua praktika e ndjekur për zëvendësimin e prokurorëve dhe shkaqet e zëvendësimit të tyre, në përfundim janë evidentuar gjetjet, si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse. Prokuroritë subjekte të inspektimit janë njoftuar për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje e Raportit të Inspektimit me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Adresimi i rekomandimeve ka qenë si ndaj prokurorive, sipas gjetjeve, ashtu dhe ndaj vetë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas përfundimit të inspektimit, prokurorive të inspektuara u është kërkuar^[1] informacion nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në lidhje me masat e marra për zbatimin e këtyre rekomandimeve, ku për prokuroritë Dibër, Durrës dhe Vlorë ishte rekomanduar plotësimi i

^[1] Shkresa nr. 2440/1 prot., datë 17.09.2024.

mangësive në praktikat e zëvendësimit, mbajtja e tyre si akte më vetë të drejtuesit, përditësimi i të dhënave në regjistrin elektronik edhe me procedurën e zëvendësimit të prokurorit, si dhe respektimi i anës formale dhe arsyetimit të akteve të zëvendësimit të prokurorit.

Në përgjigje të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve Prokuroria Durrës^[2] ka informuar se çështjet për zëvendësim janë shortuar manualisht. Lidhur me shortimin e materialeve janë nxjerrë urdhrat përkatës nga drejtuesi i prokurorisë, kryesisht në rastet e shortimit të dosjeve të prokurorëve të transferuar në një prokurori tjetër. Gjithashtu nga drejtuesi i prokurorisë është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 68, datë 25.7.2025 “Për masat procedurale dhe administrative për trajtimin e deklarimeve për heqje dorë/kërkesave për zëvendësimin e prokurorëve dhe zëvendësimi i prokurorëve me iniciativën e drejtuesit të Prokurorisë. Në këtë udhëzim rregullohet praktika e shqyrtimit të kërkesave për heqje dorë dhe procedurat e përjashtimit të prokurorit me kërkesë të palëve. Në sistemin elektronik është ndryshuar evidenca e të dhënave duke pasqyruar në mënyrë kronologjike zëvendësimin e prokurorit, duke përcaktuar datën e zëvendësimit dhe emrin e prokurorit të zëvendësuar. Për të balancuar ngarkesën në punë evidentohet se janë përfshirë në short edhe drejtuesit e seksioneve dhe vetë drejtuesi i prokurorisë në zëvendësimin e prokurorëve të larguar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë^[3] ka informuar se zëvendësimi i prokurorëve në rastet e largimit ose lëvizjes së prokurorëve, është bërë në bazë të urdhërit të drejtuesit të prokurorisë dhe shortit manual të rregulluar me urdhrin nr. 5, datë 4.12.2024, duke u mbajtur procesverbalet përkatëse dhe vendimet e zëvendësimit për çdo procedim. Gjithashtu janë marrë masat për përditësimin e të dhënave në sistemin elektronik, duke pasqyruar në mënyrë kronologjike rastet e zëvendësimit të prokurorëve, datën e saktë kur është kryer regjistrimi, datën kur është kryer zëvendësimi, si dhe emrin e prokurorit të mëparshëm dhe emrin e prokurorit të ri. Janë marrë masa për përfshirjen në short dhe të drejtuesit të prokurorisë dhe në zëvendësimin e prokurorëve të larguar apo me lëvizje paralele të përfshihen në short edhe drejtuesit e seksioneve.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër^[4] në zbatim të rekomandimeve të lëna ka informuar se nga kjo prokurori është vijuar me mbajtjen e praktikave të plota të procedurës së zëvendësimit të prokurorëve dhe trajtimin e tyre si akte të drejtuesit dhe në një regjistër elektronik të zëvendësimeve. Kjo prokurori ka mbajtur në vëmendje anën formale të akteve të procedurës së zëvendësimit të prokurorëve dhe ka ndjekur standardin e arsyetimit të tyre.

Me vendimin nr. 14, datë 01.04.2025 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur:

^[2] Shkresa nr. 4234/1 prot., datë 10.10.2025 “Kthim përgjigje”

^[3] Shkresa nr. 16469/1 prot., datë 16.10.2025 “Kthim përgjigje”

^[4] Shkresa nr. 2957/1 prot., datë 13.10.2025 “Dërgohet informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve”

1. "Kryerjen e inspektimit tematik me objekt: *"Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2024-31.12.2024"*.

2. Inspektimi tematik do të zhvillohet pranë:

- a) Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- b) Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- c) Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

3. Inspektimi tematik u zhvillua gjatë periudhës kohore 01.04.2025-31.12.2025, si dhe u realizua dhe përfundoi sipas këtyre fazave:

- a) përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, brenda datës 10.04.2025;
- b) përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur, brenda datës 16.05.2025-20.06.2025;
- c) hartimi i raportit përfundimtar do të përfundojë brenda datës 31.12.2025;
- d) ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit brenda gjashtë muajve nga data e miratimit të raportit përfundimtar të inspektimit.

4. Inspektimi tematik u krye nëpërmjet administrimit nga prokuroritë e lartpërmendura, të të dhënave, informacionit apo dokumentacionit shkresor si:

- a) Informacion nga Drejtuesi i prokurorisë mbi procedurën/praktikën që është ndjekur në prokurorinë nën drejtimin e tij për zëvendësimin e prokurorit, në periudhën 01.01.2024-31.12.2024, i cili tregon mënyrën e të proceduarit për zëvendësimin e prokurorit, mbi bazën e deklarimit të prokurorit për heqje dorë ose në rast se ka kërkesë nga palët/subjektet e procedimit penal, hyrjen/protokollimin e tyre, kalimin e tyre tek drejtuesi, marrjen dhe komunikimin e vendimit për pranimin ose jo nga Drejtuesi, si dhe lidhur me raste të ankimit ndaj vendimit mbi zëvendësimin e prokurorit të Drejtuesit të Prokurorisë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
- b) Dokumentacionin e plotë fizik të çdo praktike për "Zëvendësimin e prokurorit" për periudhën kohore 01.01.2024-31.12.2024, ku të përfshihet dokumentimi i procedurës së caktimit të prokurorit të ri.
- c) Çdo e dhënë apo akt tjetër që çmohej si i rëndësishëm për kryerjen e këtij inspektimi tematik, në përputhje me parashikimet e nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

5. Për kryerjen e këtij inspektimi, u ngarkuan inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtme:

- a) Inspektori Z. Julian Zonja, asistuar nga Ndhmësinsektore znj. Alma Troshani për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Dibër.
- b) Inspektore Znj. Lindita Ziguri asistuar nga Ndhmësinsektore znj. Loreta Jashari për

Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Dibër.

6. Me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe mirëadministrimit të procesit, u caktua si Kryetar grupi z. Julian Zonja, përgjegjës për bashkërendimin e punës, vendosjen e kontakteve me drejtuesit e prokurorive, kërkimin e informacionit, ndjekjen e ecurisë së punës, administrimin e korrespondencës në një databazë për aksesim nga i gjithë grupi i inspektimit, unifikimin e praktikës së punës për strukturën e projekt-raportit të inspektimit, koordinimin e punës për hartimin e raportit përfundimtar, informimin periodik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe paraqitjen e draft-raportit përfundimtar të inspektimit me gjetjet përkatëse për miratim nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

7. Kryetari i grupit, në bashkëpunim me inspektorët përgjegjës, hartoi dhe dorëzoi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, planin për vijimin e punës, brenda datës 03.04.2025.

8. Kryetari i grupit të inspektimit ka raportuar në përfundim të çdo faze inspektimi të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe në çdo rast që është kërkuar prej tij.

9. Projektvendimi dhe raporti i inspektimit hartohet nga inspektorët dhe i dërgohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shqyrtim, brenda datës 31.12.2025, sipas përcaktimeve të nenit 214, pika 6 të ligjit nr. 115/ 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

• Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e prokurorive subjekt i këtij inspektimi, për periudhën 01.01.2024 deri në 31.12.2024, me fokus marrjen e të dhënave në tre drejtime kryesore:

- (i) Dokumentacionin lidhur me shkaqet e çdo deklarimi të prokurorëve për heqje dorë, përfshirë ato me kërkesë të palëve/subjekteve të tjera të procedimit penal dhe vendimet e drejtuesit me arsyetimin përkatës për pranimin ose jo të tyre.
- (ii) Dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për vendimet e marra nga drejtuesi për zëvendësimin e prokurorit pa pëlqimin e tij.
- (iii) Dokumentacionin lidhur me çdo praktikë për procedurën e shortit dhe caktimin e prokurorit zëvendësues.

Qëllimi i këtij inspektimi tematik është vlerësimi i praktikave në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, lidhur me shkaqe të bazuara në ligj për të cilat prokurorët deklarojnë “*Heqjen dorë*” apo palët/subjektet kërkojnë zëvendësimin e prokurorit gjatë hetimeve paraprake ose gjatë gjykimit të çështjes; veprimtaria e drejtuesve të prokurorive në lidhje me vendimarrjen e tyre për pranim ose jo dhe zëvendësimin e prokurorit; zbatimi i caktimit me short të prokurorit të ri dhe nëse

procedohet edhe me njoftimin e zëvendësimit, prokurorëve të interesuar/palës ose subjekteve të tjera.

Në këtë inspektim u shqyrtua dokumentacioni i rasteve të zëvendësimit i dërguar nga çdo prokurori, për të konstatuar aktet që përmban dhe ato që mungojnë në një praktikë zëvendësimi. Gjithashtu u pa ana formale e akteve nëpërmjet të cilëve prokurori deklaroi heqjen dorë dhe drejtuesi merr vendim, shkaqet ligjore ku bazohen, si dhe arsye të tjera të zëvendësimit të prokurorëve. Në vazhdim, me analizimin e praktikave, u evidentua në mënyrë të përmbledhur respektimi i procedurës për heqjen dorë të prokurorit dhe zëvendësimin e tij në çdo prokurori, shkaqet konkrete për të cilat është pranuar ose nuk është pranuar zëvendësimi i prokurorit, si dhe problematikat e përgjithshme të tyre.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, mundësoi njohjen për vitin 2024 të praktikës që ndiqet për zëvendësimin e prokurorëve, shkaqet e zëvendësimit, çështje të interpretimit të dispozitave ligjore dhe autoritetit të drejtuesit të prokurorisë për të vendosur mbi pranimin ose jo të zëvendësimit të prokurorëve.

Nga të dhënat e administruara gjatë këtij inspektimi për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024 rezultoi se:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1017/5 prot., datë 04.04.2025, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në lidhje me praktikën e zëvendësimit të prokurorëve të kësaj prokurorie.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me shkresën nr. 896 prot., datë 11.04.2025 regjistruar pranë ILD-së me nr. 1017/6 prot., datë 14.04.2025 janë dërguar praktikën e zëvendësimit të prokurorëve nga hetimet e kallëzimeve/procedimeve penale. Konkretisht praktikën e përcjella nga kjo prokurori janë:

1. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë (Deklarim për heqje dorë datë 27.02.2024) nga kallëzimi penal (material hetimor i dërguar nga Komisariati i Policisë), bazuar në nenet 17, shkronja “ë” dhe 26 të K. Pr. Penale, me shkakun: *“nga ana e shtetases së përfshirë në këtë ngjarje, familjarët e saj dhe gazetarët e një emisioni investigativ të një televizionit, është komentuar vendimmarrja e tij si prokuror në trajtimin e këtij materiali kallëzues”*. Me vendimin “Për shqyrtimin e deklaratës së prokurorit për heqje dorë” datë 05.03.2024, drejtuesi, bazuar në nenet 17 dhe 26 të K. Pr. Penale, *“me qëllim për të shmangur çdo lloj paragjykimi dhe*

arsye njëanshmërie të çështjes, si dhe në respektim të parimit që drejtësia jo vetëm të jepet por edhe të duket, e ka gjetur të drejtë deklaratën e prokurorit për heqje dorë nga hetimi i materialit kallëzues dhe ka vlerësuar ta pranojë atë, duke vendosur pranimin e deklaratës së prokurorit dhe zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e ri në hetimin e materialit kallëzues. Prokurori i ri është caktuar në vendim. Referuar dispozitivit të vendimit, rezulton të jetë vendosur që me këtë vendim të njihet prokurori i mëparshëm dhe prokurori i ri.

2. Kallëzuesi i ka drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kërkesë me objekt “Përfundimin e prokurorit”, i cili rezulton të jetë Drejtues i Prokurorisë, me shkakun “pasi sipas tij ka treguar neglizhencë duke mos përfunduar hetimet brenda afateve të caktuara nga gjykata, ka humbur besueshmërinë që prokurori mund të marrë vendim të drejtë dhe ka treguar njëanshmëri”. Drejtuesi i Prokurorisë i ka dërguar Memo nr. 331, datë 11.7.2024, Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e këtij shtetasi, ku ai ka çmuar se nuk e gjen veten në kushtet për të hequr dorë ose për t’u zëvendësuar. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin datë 18.07.2024 ka konstatuar, se vlerësimi i pretendimeve të kërkuarit në lidhje me ecurinë e procedimit penal apo mënyrën e zgjidhjes së tij apo vlerësimit të provave, nuk është kompetencë e drejtuesit të prokurorisë së Apelit dhe aq më tepër të vlerësohen prej një vendimmarrjeje zëvendësim prokurori dhe bazuar në nenin 26 dhe 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Vendimi i është njoftuar Drejtuesit dhe kërkuarit.
3. Shtetasi i dyshuar për kryerjen e veprës penale, në ngarkim të të cilit është regjistruar procedimi penal, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, referim për kompetencë tek Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku ka kërkuar përfundimin/zëvendësimin e prokurorit të çështjes, i cili rezulton të jetë Drejtues i Prokurorisë, me shkakun “se procedimi penal nr. *** i vitit 2024 ka kaluar me short manual dhe jo me short elektronik nga një prej prokurorëve (prokuror i shkarkuar nga KPA) tek prokurori që është edhe Drejtuesi i Prokurorisë, i cili duke njohur mirë konfliktin e mëhershëm duhet të kishte dhënë dorëheqjen në referim të nenit 26 të K. Pr. Penale i cili në vetvete referon shkaqet dhe arsyet e dorëheqjes të parashikuara në nenin 15, 17 dhe 18 të K. Pr. Penale. Ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie me veprime/mosveprime, pasi ka pasur një konflikt të mëparshëm midis të pandehurit dhe viktimës dhe kjo vepër penale është proceduar penalisht nga i njëjti prokuror, etj. Drejtuesi i Prokurorisë i ka dërguar Memo nr. 445, datë 30.9.2024, Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e këtij shtetasi, ku ai ka çmuar se nuk e gjen veten në kushtet për të hequr dorë ose për t’u zëvendësuar. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin datë 4.10.2024 ka vendosur (mungon faqja 16 e vendimit) mospranimin e kërkesës për zëvendësim. Vendimi i është njoftuar

Drejtuesit dhe kërkuesit.

Për periudhën nga 01.01.2024-31.12.2024, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nuk ka pasur raste të ankimit ndaj vendimit mbi zëvendësimin e prokurorit, të Drejtuesit të Prokurorisë, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gjithashtu nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është paraqitur edhe 1 (një) rast, ku prokurori bazuar në ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, K. Pr. Penale, *ka vlerësuar se materiali kallëzues duhet t’i kalojë për hetim prokurorit për ndjekjen e grupveprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, me të mitur viktimë dhe/ose me të mitur dëshmitarë, pasi viktima nga vepra penale është i mitur*, dhe me informacionin në lidhje me zëvendësimin e prokurorit të datës 15.10.2024 i është drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë. Drejtuesi i Prokurorisë, me qëllim vazhdimin e hetimeve, bazuar në nenin 27, pika 1 të K. Pr. Penale dhe nenin 43, gërma “d” të ligjit nr. 97, datë 06.10.2016, me vendimin datë 22.10.2024 ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e ri për të ndjekur hetimet në lidhje me procedimin penal. Prokurori i ri është caktuar në vendim. Referuar dispozitivit të vendimit, rezulton të jetë vendosur që me këtë vendim të njihet prokurori i ri.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1017/3 prot., datë 04.04.2025, ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në lidhje me zëvendësimet e prokurorëve në këtë prokurori. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1566/1 prot., datë 25.04.2025 regjistruar pranë ILD me nr. 1017/8 prot., datë 28.04.2025 duke dërguar këto akte:

Me Urdhrin nr. 67, datë 25.09.2024 “Mbi mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së çështjeve/materialeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” të Drejtuesit të prokurorisë znj. Suela Beluli është urdhëruar ndër të tjera: 4. *Shpërndarja me short manual dhe seksioneve përkatëse të çështjeve në rastet kur prokurori që ka ndjekur çështjen është transferuar, larguar, apo për ndonjë arsye mungon në detyrë për një kohë të gjatë, ka hequr dorë apo zëvendësohet si më poshtë:*

- *Çështjet e pushuara, pezulluara apo të mosfilluara më parë për të cilat më vonë është vendosur rifillimi i ndjekjes penale;*
- *Çështjet në gjykim;*
- *Gjykimet për rivlerësimin e masave mjekësore periodike;*
- *Referimet dhe procedimet pasurore.*

5. Në shpërndarjen e çështjeve mbahet parasysh seksioni, numri i prokurorëve, ngarkesa në punë dhe ruajtja e një raporti të drejtë të ngarkesës së prokurorëve. Në rast të një numri të madh çështjesh, drejtuesi mund të parashikojë një raport tjetër të ndarjes së çështjeve ndërmjet prokurorëve. Në raste të veçanta si ngarkesa e madhe apo kompleksiteti i çështjes në trajtim dhe për arsye të justifikuara, kur Drejtuesi i prokurorisë e vlerëson të nevojshme, mund të përjashtojë me urdhër të arsyetuar një ose disa prokurorë nga pjesëmarrja në short.....

- 1- I pandehuri ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga përfaqësimi më tej i akuzës në procedimin penal, kërkesë nr. 1198 prot., datë 23.9.2024 drejtuar Drejtueses së Prokurorisë dhe për dijeni prokurores së çështjes, me shkakun: “për njëanshmëri të prokurores, shkelje të ligjit (shkelje procedurale), etj”. Drejtuesja e Prokurorisë, bazuar në nenin 27/2/3 të K.Pr. Penale dhe nenit 49 të ligjit nr. 97/2016, me vendimin datë 26.9.2024 ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit për zëvendësimin e prokurorit dhe zëvendësimin e prokurorit për vijimin e përfaqësimit të procedimit penal me një prokuror të Seksionit të Posaçëm, sipas shortit. Shkakun i pranimin sipas vendimit: “pavarësisht se nga ana e prokurores nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo mosveprim që të tregojë njëanshmëri (procedimi është kërkuar të dërgohet për gjykim dhe tashmë është kompetencë e gjykatës), tek i pandehuri dhe mbrojtësi i tij është krijuar perceptimi i “njëanshmërisë” së prokurores, perceptim i cili sipas tyre është i bazuar dhe gjerësisht i argumentuar në kërkesën drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë. Tek kjo e fundit është evidente se ato kanë krijuar bindjen se në hetimin dhe në zgjidhjen e kësaj çështjeje nga ana e prokurorit është mbajtur një qëndrim subjektiv dhe i njëanshëm. Për t’i garantuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij se në gjykimin e çështjes së tij do të zbatohen parimet e procesit të drejtë ligjor në thellim të cilave është paanshmëria, vlerësohet se kërkesa duhet të pranohet. Me procesverbalin “Për dokumentimin e shortit manual” datë 26.09.2024 është hedhur shorti manual midis prokurorëve të seksionit përkatës dhe me short manual është caktuar prokurori i ri. Sipas vendimit të zëvendësimit me këtë vendim njihet prokurori që zëvendësohet dhe prokurori që caktohet sipas shortit, si dhe Zyra e Regjistrimit. Prokurori i ri ka nënshkruar mbi vendim që mori një kopje të tij, si dhe datën përkatëse.
- 2- Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga trajtimi i procedimit penal (deklaratë për heqje dorë datë 29.2.2024), bazuar në nenin 17/ë, 24, 26, 27, 277 e vijues të K. Pr. P, ligjin 97/2016, Urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014 “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve” neni 3, 5, 7, 14, me shkakun: “pasi ka konstatuar se një shtetas më parë është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale në lidhje me çështjen penale ku ka mbetur viktimë motra e tij dhe për të shmangur çdo lloj dyshimi në lidhje me raportin që mund të ketë patur ky shtetas në lidhje me këtë ngjarje, si dhe për të shmangur çdo lloj paragjykimi të tij në raport me trajtimin e këtij procedimi penal, deklaroi heqjen dorë nga hetimi i këtij procedimi penal”. Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin datë

1.3.2024, bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e ri në hetimin e kësaj çështjeje. Me procesverbalin “Mbi dokumentimin e shortit manual” datë 1.3.2024, në seksionin përkatës është hedhur shorti manual dhe në përfundim shorti i ka rënë prokurorit të ri. Sipas vendimit, palët e interesuara duhet të njoftohen me këtë vendim.

- 3- Prokurorja ka kërkuar heqjen dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale në kallëzimin penal, (kërkesë me datë 08.07.2024), në respektim të nenit 26/1 dhe 17/ë të K. Pr. Penale, me shkakun *“nga përmbajtja e kallëzimit penal ka rezultuar se personi i cili ka bërë këtë kallëzim është komshija e saj në qytetin ku ajo banon, në Tiranë, jetojnë në të njëjtin pallat dhe përpara se të paraqitej për të bërë kallëzimin ka konsultuar ngjarjen me të, për shkak të miqësisë që kishin dhe detyrës që ajo ushtron, nisur nga natyra e ngjarjes dhe veprimet që ishin kryer për tjetërsimin e sendit, ku e ka orientuar që të bënte kallëzim penal, duke vlerësuar se fakti i sipërcituar përbën shkak “njëanshmërie” që mund të ndikonte në trajtimin e materialit kallëzuar ka paraqitur heqjen dorë”*. Drejtuesi i prokurorisë me vendimin datë 12.7.2024, bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e ri. Me procesverbalin “Mbi dokumentimin e shortit manual” datë 12.07.2024 është hedhur shorti në seksionin përkatës dhe në përfundim i është shortuar prokurorit të ri. Sipas vendimit, palët e interesuara duhet të njoftohen me këtë vendim.
- 4- Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i materialit kallëzues, bazuar në nenin 17/1 “ë” e 26 të K. Pr. Penale, me shkakun: *“ka njohje shoqërore e miqësore me të kallëzuarën”*. Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin datë 19.06.2024 bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me prokurorit të ri. Caktimi i prokurorit të ri është bërë me short manual. Sipas vendimit, palët e interesuara duhet të njoftohen me këtë vendim.
- 5- Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal, bazuar në nenin 17/ë dhe 26/1 të K. Pr. Penale, me shkakun: *“nga përmbajtja e objektit material të kallëzimit penal, inxhinieri që ka kryer planin arkitektonik dhe planvendosjen është bashkëshorti i motrës dhe vlerësohet se përbën shkak njëanshmërie”*. Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin datë 19.3.2024 ka vendosur pranimin e heqjes dorë dhe zëvendësimin e prokurorit. Caktimi i prokurorit të ri është bërë me short manual. Sipas vendimit, palët e interesuara duhet të njoftohen me këtë vendim.
- 6- Prokurorja ka deklaruar “Për heqjen dorë nga procedimi penal” dhe zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 16, 17/e, 17/ç, 17/dh, 26 të K. Pr. Penale, me shkakun: *“se bashkëshorti i prokurores, në cilësinë e gjyqtarit, ka dhënë vendime civile për palët në këtë procedim penal dhe vlerëson se është në kushtet e konfliktit të interesit për të hetuar procedimin penal, për më tepër kur njëra nga palët ndihet e kërcënuar nga vendimi civil”*.

Drejtuesi i prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurores. Caktimi i prokurorit të ri është bërë me short manual. Sipas vendimit, me këtë vendim duhet të njihet ndër të tjerë edhe prokurori.

- 7- Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes procedimi penal, bazuar në nenin 17 e 26 të K. Pr. Penale, me shkakun: *“nga ana e kallëzueses është shprehur mosbesim në hetimin e çështjes duke pretenduar për shkaqe njëanshmërie e mosmarrëveshje, si dhe është paraqitur ankesë ndaj prokurorit në ONM”*. Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin datë 18.11.2024 ka vendosur zëvendësimin e prokurorit. Caktimi i prokurorit të ri është bërë me short manual. Sipas vendimit, me këtë vendim duhet të njihet prokurori që hoqi dorë dhe prokurori i ri që do të caktohet pas shortit.
- 8- Prokurori ka kërkuar zëvendësimin dhe ndjekjen ligjore të kësaj çështjeje nga një prokuror tjetër, me shkakun: *“I pandehuri është lidhje e afërt farefisnore me bashkëshorten e prokurorit”*. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e prokurorit me prokurorin e ri. Caktimi i prokurorit të ri është bërë me short manual. Sipas vendimit, me këtë vendim duhet të njihet prokurori që hoqi dorë dhe prokurori i ri që do të caktohet pas shortit.

Rezulton të jenë përcjellë 36 (tridhjetë e gjashtë) praktika zëvendësimi të tjera, të cilat janë informacione ose kërkesa të paraqitura nga prokurori për kalimin e kallëzimit penal/procedimit penal në seksionin kompetent, 35 (tridhjetë e pesë) për *Seksionin për të Mitur dhe Ekzekutimin e Vendimeve penale* dhe 1(një) praktikë/kallëzim për Seksionin e Posaçëm. Informacionet apo kërkesat janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale, duke caktuar prokurorin e ri me short manual, raste për të cilat janë paraqitur edhe procesverbalet e shortit.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është paraqitur edhe 1 (një) rast i zëvendësimit të prokurorit për shkak të rifillimit të hetimeve të pezulluara, fashikull i cili i përkiste ish Prokurorisë Kavajë; janë paraqitur 12 (dymbëdhjetë) raste të zëvendësimit të prokurorit për shkak të lejes së lindjes; 2 (dy) raste zëvendësimi për arsye shëndetësore; 2 (dy) raste, kur çështja ka qenë në ndjekje nga një prokuror i cili është rikthyer në detyrë dhe nga ana e prokurorit të zëvendësuar nuk është kryer asnjë veprim; 89 (tetëdhjetë e nëntë) raste, vendime zëvendësimi, për procedime të përcjella nga Komisariati i Policisë Durrës me qëllim rifillimin e hetimeve për efekt parashkrimi.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në bazë të Urdhrit për shortimin e materialeve dhe procesverbaleve të shortit manual, janë paraqitur edhe vendimet e zëvendësimit të prokurorit të marra në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale për:

- çështjet penale në hetim dhe në gjykim, për 5 (pesë) prokurorë të pezulluar (shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit), 1 (një) prokuror i shkarkuar me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, (gjithsej 312 çështje/procedime penale).
- çështjet penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim, për një prokuror të pezulluar për një vit me vendim të KPK-së, ku Drejtuesi i prokurorisë ka urdhëruar edhe përjashtimin e tij nga shorti (gjithsej 236 çështje).
- çështjet penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim të 3 (tre) prokurorëve të transferuar me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në prokurori tjetër (gjithsej $6+2+2=10$ çështje).
- çështjet penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim të një prokurori për shkak të caktimit të tij si drejtues i kësaj prokurorie dhe një prokuror si drejtues i një prokurorie tjetër (gjithsej $106+167=273$ çështje).
- çështje penale në fazë verifikimi, në hetim dhe në gjykim të një prokurori për shkak të caktimit të tij në një prokurori tjetër me vendim të KLP-së (Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) (gjithsej 30 çështje).

Janë paraqitur Urdhrat e Drejtuesit të Prokurorisë:

- Urdhër nr. 59, datë 09.09.2024 për trajtimin e materialeve të prokurorit të emëruar me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në një prokurori tjetër (Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar), ku është urdhëruar shpërndarja nëpërmjet shortit manual e të gjitha dosjeve në hetim dhe në gjykim që kanë qenë në ndjekje nga ky prokuror;
- Urdhër nr. 62, datë 12.09.2024 për trajtimin e materialeve të prokurorit të caktuar përkohësisht të ushtrisë detyrën e Drejtuesit të kësaj prokurorie me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku është urdhëruar shpërndarja nëpërmjet shortit manual e të gjitha dosjeve në hetim dhe në gjykim që kanë qenë në ndjekje nga ky prokuror;
- Urdhër nr. 24, datë 19.04.2024 për shortimin e procedimeve penale në hetim dhe gjykim për shkak të shkarkimit të prokurorit me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku është urdhëruar hedhja në short manual e të gjitha procedimeve penale në hetim dhe gjykim si dhe materialet hetimore të cilat janë dorëzuar nga prokurori;
- Urdhër nr. 34/2 prot., datë 10.05.2024 për përjashtimin e prokurorëve nga shorti elektronik dhe manual, për shkak të pezullimit nga detyra të prokurorit për një vit nga KPK, ku është urdhëruar që prokurori të përjashtohet nga shorti duke filluar nga data 10.05.2024 pa afat të caktuar;
- Urdhër nr. 14, datë 26.01.2024 për shortimin e procedimeve penale në hetim, për shkak të shkarkimit nga detyra të prokurorit me vendim të Komisionit të Pavarur të kualifikimit, ku është urdhëruar që të hidhen në short manual të gjitha procedimet penale në hetim dhe gjykim, si dhe materialet hetimore, të cilat janë dorëzuar nga prokurori;
- Urdhër nr. 23, datë 03.04.2024 për shortimin e procedimeve penale në hetim dhe gjykim, ku për shkak të caktimit të përkohshëm të prokurorit si drejtuese në një prokurori tjetër, me vendim të KLP-së është urdhëruar që të hidhen në short manual të gjitha procedimet

penale në hetim dhe gjykim, si dhe materialet hetimore të cilat janë dorëzuar nga prokurori

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 1017/4 prot., datë 04.04.2025 ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në lidhje me zëvendësimet e prokurorëve në këtë prokurori. Në përgjigje të kërkesës nga aktet e dërguara nga kjo prokurori rezulton se:

1. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimet e procedimit penal, (Kërkesë me datë 16.01.2024) bazuar në nenin 26, pikat 1, 2 dhe 3 të K. Pr. Penale me shkakun se *“bazuar në vendimmarrjet e tij si prokuror i cili ka hetuar çështje të mëparshme të kallëzuesit dhe faktit se ky i fundit ka paraqitur kallëzim edhe në ish- Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë ndaj tij dhe për nevoja të një hetimi objektiv dhe të paanshëm, në mënyrë që vendimmarrja të mos paragjykohej kërkon heqjen dorë”*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë ka marrë vendimin datë 18.01.2024 *“Për zëvendësim prokurori”*, për pranimin e kërkesës bazuar në nenet 17, 26/2 të K. Pr. Penale dhe në këtë rast procedimi është shortuar elektronikisht.
2. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga kallëzimi penal, (Kërkesë me datë 02.02.2024), bazuar në nenet 17/1/d e 26/2/3 të K. Pr. Penale me shkakun se: *“me kallëzuesin prokurori ka lidhje të afërta gjinie dhe konkretisht është xhaxhai i tij”*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë ka marrë vendim datë 05.02.2024 *“Për miratimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësim prokurori”*, bazuar në nenet 17/1/d, 26/2/3 të K. Pr. Penale dhe në këtë rast procedimi është shortuar manualisht.
3. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale për materialin kallëzues, (Kërkesë me datë 12.02.2024), me shkakun se *“nga materialet e dosjes hetimore rezulton se kallëzuesi pretendon se është falsifikuar firma e vëllait të tij në njoftimin e bërë nga gjykata Vlorë për të marrë pjesë në gjykimin e kërkesës për pushim të dërguar nga Prokuroria Vlorë lidhur me procedimin penal, i cili është hetuar nga ana e tij ”*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë ka marrë vendimin datë 12.02.2024 *“Për miratimin e kërkesës për heqje dorë dhe zëvendësim prokurori”* bazuar në nenet 17/ç dhe 26 të K. Pr. Penale dhe në këtë rast procedimi është shortuar manualisht.
4. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga përfaqësimi i çështjes penale, (Kërkesë me datë 12.02.2024) bazuar në nenet 17 dhe 26 të K. Pr. Penale me shkakun se: *“viktima e veprës penale pretendon se kjo vepër ka lidhje me konfliktet e tij me z. A.M., i cili ka qenë gjyqtar dhe kryetar i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku ajo ka qenë sekretare”*. Bazuar në këtë kërkesë,

Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin datë 12.02.2024 “Për zëvendësim prokurori” për pranimin e kërkesës, bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe në këtë rast procedimi është shortuar manualisht.

5. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Memo datë 08.04.2024) bazuar në nenet 17 dhe 27 të K. Pr. Penale me shkakun se: *“nga studimi i materialeve ka konstatuar se ka lidhje familjare me gjyqtarin e hetimeve paraprake dhe ka kërkuar përjashtimin”*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin datë 15.04.2024 “Për zëvendësim prokurori”, bazuar në nenet 16, 17 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe ngarkimin e vetes me hetimin e këtij procedimi.
6. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Deklaratë me datë 27.05.2024) bazuar në nenet 17 dhe 26 të K. Pr. Penale me shkakun se: *“ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit, i cili përgjithësisht bën fjalë për të njëjtin kallëzues dhe të njëjtin fakt penal*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin datë 31.05.2024 “Për zëvendësim prokurori”, bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe hedhjen në short elektronik të kallëzimit penal në Seksionin për Hetimin e Krimeve të Përgjithshme, ku pas shortimit i ka kaluar prokurorit të ri.
7. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Deklaratë me datë 30.05.2024), me bazë ligjore ligjin nr. 97/2016, i ndryshuar, me shkakun se: *“...kallëzuese në këtë procedim është shtetasja, e cila ka paraqitur disa ankesa në institucione të ndryshme dhe kallëzim penal lidhur me procedimet penale të hetuara nga ana e tij, ku kallëzuese ka qenë kjo shtetase...”*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 03.06.2024 bazuar në nenet 17/ç dhe 26 të K. Pr. Penale dhe hedhjen në short elektronik të kallëzimit penal, në Seksionin për Hetimin e Krimeve të Përgjithshme, ku pas shortimit i ka kaluar prokurorit të ri.
8. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Deklaratë me datë 03.06.2024), me bazë ligjore nenet 16, 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, me shkakun se: *“...si rezultat i përgjimeve të administruara më datë ... dhe të transkriptuara pjesërisht më datë kanë rezultuar disa komunikime telefonike, ku këto subjekte po tentojnë të influencojnë në lidhje me një gjykim penal në gjykatën Vlorë, me gjyqtarin me të cilin ka lidhjeve familjare dhe kërkon të heqë dorë nga hetimi i këtij procedimi...”*. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 05.06.2024, bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe ka ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal prokurorin e Seksionit për Hetimin e Krimit Ekonomik, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Hetimit Pasuror.
9. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Deklaratë me datë

01.07.2024), me bazë ligjore ligjin nr. 97/2016, i ndryshuar, me shkakun se: “....kallëzuesi ka depozituar në Prokurorinë Vlorë një kërkesë për heqje dorë nga hetimi i këtij procedimi, pasi ai ka vendosur mosfillimin e procedimit, për një kallëzim të tij të mëparshëm...”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 01.07.2024 bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe është ngarkuar zyra e regjistrimit të bëjë shortimin manual, ku pas shortimit manual është caktuar prokurori i ri.

10. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Memo me datë 03.07.2024), me bazë ligjore nenet 16, 17 dhe 26 të K. Pr. Penale, me shkakun se: “....nga studimi i materialeve të dosjes rezulton se ka lidhje familjare me gjyqtarin e hetimeve paraprake...”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori” datë 09.07.2024, për pranimin e kërkesës, bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe hedhjen në short të procedimit penal, ku pas shortimit manual është caktuar prokurori i ri.
11. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i kallëzimit penal, (Deklaratë me datë 16.07.2024) me bazë ligjore ligjin nr. 97/2016, i ndryshuar, me shkakun se: “Kallëzuesi është marrë i pandehur nga prokurori dhe e ka dërguar për gjykim në kuadër të një tjetër procedimi penal”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 16.07.2024 bazuar në nenet 17/ç dhe 26 të K. Pr. Penale dhe ngarkimin e prokurorit të ri me hetimin e këtij materiali kallëzues.
12. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale (Memo me datë 09.09.2024), me bazë ligjore nenet 16, 17 të Kodit të Procedurës Penale, me shkakun se: “....nisur nga fakti se kallëzimi penal është paraqitur nga shtetasi R.N dhe se fakti i pretenduar është edhe vepra penale e “mashtimit”, nga ana e të akuzuarit në kallëzim S.Q, për të cilin është regjistruar një procedim penal nr. .../viti 2019, i cili është dërguar për gjykim dhe ka lidhje familjare me gjyqtarin e seancës paraprake”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 09.09.2024 bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale, dhe hedhjen në short të kallëzimit penal, ku pas shortimit manual është caktuar prokurori i ri.
13. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Memo me datë 16.09.2024), me bazë ligjore nenet 16, 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, me shkakun se: “....nisur nga fakti se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me vendimin datë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është ankimuar në gjykatë dhe gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore, ku ka lidhje familjare me gjyqtarin e seancës paraprake”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 23.09.2024 bazuar në

nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale, dhe hedhjen në short të kallëzimit penal, ku pas shortimit elektronik i është caktuar prokurorit të ri.

14. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale, (Memo me datë 18.11.2024), me bazë ligjore nenet 16, 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, me shkakun se: “....nisur nga materiali i procedimit penal konstatohet se, ka lidhje familjare me gjyqtarin e hetimeve paraprake”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori” datë 18.11.2024 për pranimin e kërkesës bazuar në nenet 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale, zëvendësimin e prokurores dhe hedhjen në short të procedimit penal, ku pas shortimit manual është caktuar prokurori i ri.
15. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga përfaqësimi i çështjes që ka të bëjë me procedimin penal, (Deklaratë me datë 02.12.2024), me bazë ligjore nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, me shkakun se: “....pas marrjes në dorëzim të dosjeve ka konstatuar se kjo çështje gjyqësore lidhet me një çështje të hetuar nga një prokurore dhe duke qenë se në atë kohë ka qenë Drejtuese ka shfaqur mendim në lidhje me këtë procedim....Për të shmangur çdo lloj paragjykimi në dukje, apo të nënkuptuar mbi vlerësimet e gjykimet e saj ka vlerësuar heqjen dorë nga përfaqësimi i këtij procedimi”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori” datë 03.12.2024 për pranimin e deklaratës për heqje dorë të prokurorit, bazuar në nenet 17/ë, 24, 26, 27 të K. Pr. Penale, dhe hedhjen në short të dosjes që i përket procedimit penal, ku pas shortimit manual i është caktuar prokurorit të ri. Ky vendim i është njoftuar shtetasit dhe prokurorit të mëparshëm.
16. Prokurori ka kërkuar heqjen dorë nga hetimi i çështjes, (Deklaratë me datë 27.12.2024), me bazë ligjore nenet 17/1/ç dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, me shkakun se: “bazuar nga aktet rezulton se kallëzues të kësaj veprë janë shtetasit, të cilët kanë bërë kallëzim penal ndaj saj si prokurore si dhe ankesa në KPK. Në mënyrë që të mos ketë asnjë ndikim, apo të duket si e njëanshme me qëllim shmangien e çdo lloj perceptimi njëanshmërie ka kërkuar heqjen dorë...”. Bazuar në këtë kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori” datë 27.12.2024 për pranimin e deklaratës për heqje dorë të prokurores, bazuar në nenet 17/ë, 24, 26, 27 të K. Pr. Penale, dhe hedhjen në short të dosjes që i përket, ku pas shortimit elektronik kjo çështje i është caktuar prokurores së re.
17. Personi nën hetim ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit në procedimin penal, (Kërkesë me Nr. 505 prot., datë 28.03.2024) bazuar në nenet 15-18 të K. Pr. Penale me shkakun se: “janë kryer disa veprime hetimore në laboratorin kriminalistik, si akt ekspertim i armës etj, veprime të cilat nuk përfshijnë shtetasin S. LL në mbajtjen e këtij sendi të kundërligjshëm dhe ndonëse ka kaluar shumë ditë që kanë ardhur provat ku nuk implikohet në asnjë prej tyre, prokurori nuk vepron”. Me deklaratën datë 04.04.2024 “Për

dhënie pëlqimi për zëvendësim” në kuadër të procedimit prokurori ka dhënë pëlqimin për zëvendësimin e tij në ushtrimin e ndjekjes penale në lidhje me këtë procedim. Bazuar në kërkesën e këtij shtetasi, Drejtuesi i Prokurorisë ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori” datë 04.04.2024, bazuar në nenet 17/1/ë, 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe ngarkimin e vetes për vijimin e hetimeve në kuadër të këtij procedimi

18. Shtetasja D.Sh, ka kërkuar përjashtimin e prokurorit nga hetimi i çështjes, (Kërkesë me nr. 1754 prot., datë 09.10.2024), bazuar në nenet 15-27 të K. Pr. Penale me shkakun se: *“.... ka dyshime në lidhje me objektivitetin e saj në lidhje me kallëzimin e dytë për shtëpinë e dytë. Në të tilla kushte kërkesja ka kërkuar përjashtimin e prokurores duke menduar se qëndrimi i saj i ka krijuar asaj perceptimin e njëanshmërisë”*. Me deklaratën datë 18.12.2024 “Për dhënie pëlqimi për zëvendësim” në kuadër të procedimit penal, prokurori ka dhënë pëlqimin për zëvendësimin e tij në ushtrimin e ndjekjes penale në lidhje me këtë procedim, pavarësisht se nuk çmon se është në kushtet e njëanshmërisë e as të mungesës së objektivitetit, por është e rëndësishme që përveç faktit që nuk është e njëanshme, duhet të duket e tillë me qëllim që kallëzuesi të ndihet i garantuar në të drejtat e tij. Bazuar në kërkesën e këtij shtetasi, Drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin “Për zëvendësim prokurori”, datë 18.12.2024 bazuar në nenet 17/1/c, 24 dhe 27/1 të K. Pr. Penale dhe hedhjen në short të këtij procedimi, ku pas shortimit i është caktuar prokurorit të ri.

Në (30) praktika nga prokurori me “Memo”, është konstatuar se këto materiale duhet të trajtohen nga seksioni kompetent për të miturit (Seksioni për hetimin e Veprave Penale me Persona të Mitur, për Ekzekutimin e Vendimeve Penale, Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë), bazuar në urdhrin nr. 12, datë 29.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për riorganizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”. Referuar këtyre memove, Drejtuesi i prokurorisë, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 4, pika 1 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Urdhrin nr. 12, datë 29.09.2023, në mbështetje të nenit 27 K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit, kalimin e materialit në këtë seksion dhe hedhjen në short të tij. Pas këtij vendimi është hedhur shorti elektronik në 18 raste, short manual në 9 raste, në 2 raste nuk është paraqitur fleta e shortit megjithëse në vendim zëvendësimi përcaktohet hedhja e shortit dhe në një rast prokurori i ri i këtij seksioni është caktuar në vendim. Me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 27, është vendosur zëvendësimi i prokurorit për shkak se autori i dyshuar i veprës penale ka qenë i mitur në momentin e kryerjes së veprës penale, bazuar në nenin 4 , pika 1 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Urdhrin nr. 12, datë 29.09.2023, materiali duhet të trajtohet nga ky seksion, i cili është seksioni kompetent për trajtimin e materialeve me të mitur.

Në 2 raste nga prokurori me “Memo”, është konstatuar se këto materiale duhet të trajtohen nga seksioni kompetent (Seksioni i Posaçëm), bazuar në urdhrin nr. 15, datë 08.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për riorganizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do

të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”. Referuar këtyre memove, Drejtuesi i prokurorisë, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 16, 17/b, 24, 26, 27, 277 dhe 110 të K. Pr. Penale, ligjin nr. 97/2016 dhe Urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014 “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, neni 3, 5, 7, 14 të tij, ka vendosur të pranojë me vendimin “Mbi deklaratën për heqje dorë nga ushtrimi i ndjekjes penale” deklaratën e heqjes dorë të prokurorit nga hetimi i procedimit penal, zëvendësimin e prokurorit dhe hedhjen në short për caktimin e prokurorit të seksionit të posaçëm, i cili është caktuar me short manual.

Në 22 raste nga prokurori me “Memo”, është konstatuar se këto materiale duhet të trajtohen nga seksioni kompetent (Seksioni për hetimin e Krimeve të Përgjithshme), bazuar në urdhrin përkatës nr. 12, datë 29.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për riorganizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”. Referuar këtyre memove, Drejtuesi i prokurorisë, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 24 dhe 27/1, nenin 43 dhe 49 të ligjit nr. 97/2016 ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe hedhjen në short të materialit. Kjo është bërë me short manual në 9 raste, në 1 rast nuk është paraqitur procesverbali i shortit, por në vendim është përcaktuar hedhja në short dhe 12 raste është bërë short elektronik.

Në 7 raste, nga prokurori me “Memo”, është konstatuar se këto materiale duhet të trajtohen nga seksioni kompetent (Seksioni për hetimin e Krimit Ekonomik, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Hetimit Pasuror), bazuar në urdhrin përkatës nr. 15, datë 08.09.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për riorganizimin në seksione, përcaktimin e veprave penale që do të trajtohen nga secili seksion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”. Referuar këtyre memove, Drejtuesi i prokurorisë, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 27/1 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe hedhjen në short të materialit. Kjo është bërë me short manual në 4 raste, në 3 raste është bërë short elektronik.

Në 1 rast, nga prokurori me “Kërkesë mbi deklarimin e heqjes dorë”, është deklaruar heqja dorë për shkak se procedimi duhet të kalojë tek seksioni përkatës, bazuar në urdhrin nr. 3, datë 01.02.2024 “Për riorganizimin e seksionit për hetimin e veprave penale me persona të mitur....”, por nuk rezulton të jetë dërguar vendimi i zëvendësimit.

Në 1 rast, nga prokurori me “Memo”, është konstatuar se materiali duhet të trajtohej nga prokurorja e gatshme e kohës së ndodhjes së ngjarjes, bazuar në urdhrin përkatës nr. 14, datë 14.11.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë “Për shërbimin e gatishmërisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”, nenin 2, pika 3. Referuar kësaj memo, Drejtuesi i prokurorisë, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në urdhrin nr. 14, datë 14.11.2023, neni 2, pika 3, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin për ndjekje penale të prokurores së gatshme.

Në 1 rast, nga prokurori me “Memo”, është kërkuar kalimi i materialit kallëzues prokurorit të çështjes, pasi janë kryer veprime hetimore nga prokurori i gatshëm dhe hetimi i kësaj çështjeje duhet të vijojë prej tij. Referuar kësaj Memo, Drejtuesi i prokurorisë, me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, bazuar në nenin 27 të K. Pr. Penale, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin për ndjekje penale të prokurores së gatshme.

Në 1 rast, me “Informacion” drejtuar drejtuesit, prokurori ka konstatuar se prokurori i çështjes të cilit i referohet materiali kallëzues të jetë një prokuror tjetër me të cilin pasi është diskutuar është vlerësuar që t’i kalojë atij për vlerësim, si prokuror i çështjes kryesore, pasi ai ka ndjekur jo vetëm hetimet, por edhe gjykimin e procedimit penal. Referuar këtij informacioni, Drejtuesi i prokurorisë, në kushtet e një vlerësimi të drejtë, të paanshëm dhe objektiv, si dhe referuar mënyrës së shpërndarjes së çështjeve në prokurori, ka vlerësuar që ky material t’i kalojë për vlerësim prokurorit të çështjes kryesore, bazuar në nenin 16, 17, 24, 26/2, 27 të K. Pr. Penale dhe nenit 44, pika 3, 4, të ligjit 97/2016, Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori”, Udhëzimit nr. 3/2016 “Për shpërndarjen e çështjeve”. Me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, ka vendosur zëvendësimin e prokurorit me caktimin e prokurorit që ka çështjen kryesore.

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Në funksion të realizimit të inspektimit u administruan të dhënat dhe dokumentacioni shkresor për periudhën objekt inspektimi 01.01.2024-31.12.2024, nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë, Durrës dhe Vlorë, lidhur me:

- a) procedurën për zëvendësimin e prokurorit, me deklaram të prokurorit për heqje dorë ose kërkesë të palëve/subjekteve të tjera për zëvendësimin e prokurorit; mënyrën e paraqitjes së tyre tek drejtuesit të prokurorisë për shqyrtim; marrjen e vendimit përkatës nga drejtuesi dhe komunikimin e tij; caktimin e prokurorit të ri të çështjes në rast të zëvendësimit të prokurorit (procesverbalin e shortit);
- b) praktikat e zëvendësimit pa pëlqimin e prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë;
- c) raste të ankimeve ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Mbi bazën e këtij dokumentacioni u analizuan të dhënat e marra nga zyrat e prokurorive, në drejtim të (i) shkaqeve ligjore për zëvendësimin e prokurorit të çështjes bazuar në kërkesat e palëve ose subjekteve të tjera të procedimit penal dhe deklarimeve të prokurorëve për heqjen dorë, (ii) procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit tjetër (iii) bazueshmërinë e arsyetimit të shkakut të zëvendësimit në dispozitën përkatëse ligjore.

Trajtimi i këtyre të dhënave i referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë^[5] neneve 42 shkronja “a dhe c”, 43, pika “d”^[6], 45, pika 1-2^[7], 49 pika 2^[8] të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 15, 16, 17, 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

Zëvendësimi i prokurorit në një çështje penale rregullohet nga nenet 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale dhe ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Prokurori ka detyrimin të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie, sipas rasteve të parashikuara në nenin 17 të K. Pr. Penale. Deklarimi i heqjes dorë shqyrtohet nga drejtuesi i prokurorisë dhe nëse pranohet prokurori zëvendësohet menjëherë me një tjetër. Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në raste specifike sipas nenit 16 (gjini e afërt ose krushqi e afërt) dhe nenit 17 paragrafi i parë, shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të K. Pr. Penale. Në këto raste, për të garantuar paanësinë zëvendësimi është i detyrueshëm dhe nuk kërkohet pëlqimi i prokurorit, ndërsa për arsye të tjera zëvendësimi bëhet vetëm me pëlqimin e prokurorit. Prokurori i zëvendësuar ka të drejtë ankimi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (brenda 5 ditëve), por ankimi nuk pezullon zëvendësimin.

Gjithashtu është mbajtur parasysh edhe numri efektiv i prokurorëve në çdo prokurori, duke qënë se rishpërndarja e çështjeve në rastin e zëvendësimit të prokurorit ndikon në ngarkesën e prokurorëve në prokurori, ku duke iu referuar organikës së prokurorive objekt inspektimi për vitin 2024, rezulton si më poshtë^[9]:

Shkalla e Parë	Nr. Prokurorëve sipas Organikës	Vakancë faktike	Në detyrë
Vlorë	20	5	15
Dibër	8	1	7
Durrës	33	15	18

Në vijim është pasqyruar analiza e praktikave për secilën prokurori të inspektuar, në lidhje

[5] Neni 148 i Kushtetutës përcakton se: “1. “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarrëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.”

[6] Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale:

d) merr masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj;

[7] 1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.

2. Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose paafësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.”

[8] 1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji procedural penal.

2. Prokurori mund të zëvendësohet edhe kur, për shkak të mungesës ose paafësisë së tij të përkohshme fizike për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.”

[9] Raporti vjetor për vitin 2024 miratuar me vendimin Nr.92, datë 23.05.2025 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

me procedurën që ndiqet për zëvendësimin e prokurorit dhe shkaqet e zëvendësimit sipas deklarimeve për heqje dorë/kërkesave dhe vendimeve të drejtuesit të prokurorisë referuar rasteve dhe kushteve të parashikuara në ligj. Njëkohësisht, në zyrat e prokurorive gjatë vitit 2024 zëvendësimet më të shpeshta të prokurorëve lidhen me vakancat për shkak të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe transferimeve të prokurorëve në prokurori të tjera.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër

Kjo prokurori është përgjigjur ndaj kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se, “Sa i përket procedurës/praktikës që është ndjekur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për zëvendësimin e prokurorit, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, pas momentit të bërjes së deklaramit të prokurorit për heqje dorë ose të kërkesës së palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësim të prokurorit dhe pas hyrjes/protokollimit të tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, janë kaluar tek Drejtuesi i Prokurorisë.

Në rastet e kërkesës së palëve/subjekteve të procedimit penal për zëvendësim të prokurorit, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është kërkuar mendim/informacion nga prokurori përkatës.

Pas marrjes së vendimit përkatës nga Drejtuesi i Prokurorisë për heqjet dorë/kërkesat e palëve ose subjekteve të procedimit penal, vendimi i Drejtuesit të Prokurorisë i është komunikuar prokurorit përkatës ose/edhe subjekteve të tjera në lidhje me procedurën e zhvilluar për caktimin e prokurorit tjetër.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, caktimi i prokurorit tjetër për vijimin e hetimit të procedimit penal është realizuar duke patur parasysh ngarkesën e prokurorëve dhe/ose mbi bazën e procedurës së shortit manual.”

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër rezulton që nga 3 (tre) praktika për zëvendësim, 2 (dy) janë me kërkesë të palëve (një nga kallëzuesi dhe një nga personi nën hetim) të cilat nuk janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pasi subjekt ka qenë vetë drejtuesi i prokurorisë Dibër dhe 1 (një) praktikë është me deklaramit të prokurorit të çështjes, i cili është pranuar. Në këtë të fundit prokurori i ri nuk është caktuar me short, por drejtpërdrejt nga drejtuesi në vendim. Rasti i katërt është zëvendësimi i prokurorit për shkak të kalimit të materialit prokurorit për të mitur. Në këtë rast detyrimisht prokurori është caktuar drejtpërdrejt si prokuror i vetëm i ngarkuar me hetimin e grupveprave penale për të miturit. Të katër rastet kanë të bëjnë me zëvendësimin e prokurorit në fazë hetimi.
- Sipas akteve të dërguara nga Prokuroria Dibër rezulton se, praktika e zëvendësimit që ndiqet në këtë prokurori, është se pas një kërkesë të palës për zëvendësim të prokurorit, e cila

protokollohet si çdo kërkesë, ajo i kalon drejtuesit të prokurorisë. Në rastin e kërkesës së palës prokurori për të cilin është kërkuar zëvendësimi i ka paraqitur drejtuesit të prokurorisë mendimin e vet në formë memo (ku në të dy rastet ka qenë drejtuesi i prokurorisë prokurori për të cilin është kërkuar zëvendësimi, i cili i ka paraqitur mendimin e tij drejtuesit të prokurorisë së apelit) lidhur me pretendimin e palës. Kur heqja dorë vjen si deklaram i prokurorit ky deklaram i paraqitet drejtpërdrejt drejtuesit të prokurorisë, i cili vendos dhe po ashtu vendimi i drejtuesit i kalon drejtpërdrejt prokurorit.

- Pjesë e dispozitivit të vendimit të drejtuesit është edhe komunikimi i vendimit prokurorit të interesuar ose edhe palës që ka bërë kërkesën.
- Sa i takon numrit të deklarimeve për heqje dorë për secilin prokuror rezulton se:

Nr.	Prokurori	Numri i deklarimeve për heqje dorë
1	U. Kalia	1

- Arsytet e zëvendësimit të prokurorit në Prokurorinë Dibër rezultojnë të jenë për shkaqe të konsideruara si të rëndësishme të njëanshmërisë së prokurorit, parashikuar nga neni 17, pika ë) të K. Pr. Penale.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

Në lidhje me praktikën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është përgjigjur se “Kërkesat e prokurorëve për heqje dorë deri në datë 02.08.2025 janë regjistruar në një Regjistër të veçantë të kërkesave. Pas datës 02.08.2025, kërkesat për heqje dorë të prokurorëve janë regjistruar në regjistrin e korrespondencës me drejtuesin.

Në rastet kur është pranuar kërkesa për heqje dorë/zëvendësim, caktimi i Prokurorit të ri është bërë nëpërmjet shortit manual midis prokurorëve të seksionit përkatës.

Vendimi i zëvendësimit i është njoftuar Prokurorit që ka kërkuar heqjen dorë dhe Prokurorit i cili sipas shortit është caktuar për ndjekjen e procedimit....

Në rastet e kërkesave për zëvendësim nga palët, ato janë paraqitur në zyrën e protokoll/arkivës dhe më pas kalohen në zyrën e drejtuesit. Në çdo rast palët njoftohen me vendim për pranim/mospranimin e kërkesës për zëvendësim nga drejtuesi i prokurorisë.

Sekretari i drejtuesit është ngarkuar me mbajtjen e praktikës së plotë të ndjekur për të gjitha vendimmarrjet e drejtuesit për shqyrtimin e kërkesave për heqje dorë apo përjashtim të prokurorëve”.

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton se nga 8 (tetë) raste zëvendësimi, 1 (një) praktikë është me kërkesë të palës (i pandehuri), ku është pranuar zëvendësimi i prokurorit në gjykim dhe 7 (shtatë) praktika të

tjera janë deklarime për heqjen dorë nga vetë prokurorët në hetime, të cilat edhe këto janë pranuar.

- Në lidhje me procedurën e zëvendësimit të prokurorit që ndiqet në këtë prokurori rezulton se pas protokollimit të kërkesës së palës ose deklarimit të prokurorit për heqje dorë në regjistrin e qarkullimit të korrespondencës së brendshme (megjithatë nuk kemi dokumentim të këtij fakti), ato i kalojnë drejtuesit. Në rastin e kërkesës së palës (i pandehuri) për zëvendësim të prokurorit, nuk rezulton të kërkohej mendim nga prokurori për të cilin kërkohej zëvendësimi. Pas vendimit të drejtuesit të prokurorisë për pranimin e kërkesës së palës ose të deklarimit të prokurorit për heqjen dorë, vijohet me caktimin e prokurorit të ri me short manual, parashikuar në urdhrin nr. 67, datë 25.09.2024 të drejtuesit të prokurorisë.
- Zëvendësimi i prokurorit nuk rezulton ti komunikohet palës që ka paraqitur kërkesën për zëvendësim edhe pse në përgjigje të prokurorisë referohet se në çdo rast pala njoftohet për vendimin. Ndërsa për deklarimet e heqjes dorë vendimi i zëvendësimit parashikon se ai i njoftohet të dy prokurorëve.
- Sa i takon numrit të deklarimeve për heqje dorë për secilin prokuror rezulton se:

Nr.	Prokurori	Numri i deklarimeve për heqje dorë
1	E. Hysenaj	2
2	E. Shehu	2
3	E. Xhengo	1
4	F. Reka	1
5	G. Veizi	1
6	S. Nishani	1
7	P. Gruda	1

- Arsyet e zëvendësimit të prokurorëve në këto praktika kryesisht janë për shkaqe të ndryshme që konsiderohen si të rëndësishme të njëanshmërisë, parashikuar nga neni 17 pika “ë” i K. Pr. Penale. Shkaqet e tjera të zëvendësimit të prokurorit rezultojnë për:
 - Kalimin e kallëzimit penal/procedimit penal në seksionin kompetent në bazë të informacionit ose kërkesës së prokurorit dhe vendimit të drejtuesit për zëvendësim. Prokurori i ri nga seksioni përkatës është caktuar përmes shortit manual;
 - Rifillimit të hetimit të pezulluar duke u zëvendësuar prokurori që ka vendosur pezullimin e hetimit;
 - Leje lindjeje dhe arsye shëndetësore, shkaqe këto të parashikuara në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 97/2016;
 - Largimit, pezullimit ose shkarkimit të prokurorit, i cili është zëvendësuar në bazë të urdhrin të drejtuesit për shpërndarjen e çështjeve të tyre dhe shortit manual.
 - Rikthimit në detyrë të prokurorit të mëparshëm që ka patur në ndjekje procedimin.

Në lidhje me shkakun e fundit, të zëvendësimit të prokurorit me prokurorin e mëparshëm që ka patur në ndjekje procedimin pas rikthimit në detyrë të këtij të fundit, (i larguar për disa muaj për arsye shëndetësore), i konstatuar në dy raste (PP nr. 2010/2022 dhe PP nr.690/2018) zëvendësimi gjendet jo për shkaqe të parashikuara në ligj. Në vendimin përkatës të zëvendësimit, drejtuesi i prokurorisë arsyeton se nga ana e prokurorit nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe se prokurori i mëparshëm që ka regjistruar dhe ka patur në ndjekje procedimin është rikthyer në detyrë.

Gjithashtu nga ana e zyrës së prokurorisë Durrës konstatohet edhe një rast kur nga drejtuesi i prokurorisë Durrës, është refuzuar me shkresë, kërkesa/informacioni i prokurorit të çështjes për kalimin e procedimit penal (nr.2127 viti 2024) që ndiqej prej tij, një seksioni tjetër (Seksionit për të Mitur), me argumentin se duhet të kryheshin veprime me të mitur. Sa i përket formës me të cilën drejtuesi i prokurorisë i ka kthyer përgjigje kërkesës së prokurorit të çështjes, ajo duhet të ishte me vendim, pasi në thelb ishte kërkesë për zëvendësimin e prokurorit dhe nga drejtuesi në shkresë është vlerësuar prej tij si e pambështetur në ligj, duke iu referuar në këtë rast parashikimeve në KDPM lidhur me rregullat e pyetjes së të miturve.

3. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në përgjigje të kërkesës për praktikat dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve ka informuar se *“në lidhje me procedurën e ndjekur për zëvendësimin e prokurorit, kur kërkesa paraqitet nga palët ajo depozitohet në zyrën e protokollit dhe në vijim i përcillet drejtuesit të prokurorisë, i cili pasi e shqyrton del me vendim pranimi ose mospranimi... Kur kërkesa paraqitet nga prokurori me memo ose deklarim heqje dorë, kërkesa së bashku me dosjen i përcillet drejtuesit të prokurorisë, cili pas shqyrtimit del me vendim. Në të gjitha rastet vendimi ju komunikohet palëve dhe prokurorit”*.

Nuk rezulton të ketë vendim për zëvendësimin e prokurorit pa pëlqimin e tij, si dhe as ankim drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë kundër vendimeve të marra nga drejtuesi i prokurorisë për pranimin ose mospranimin e kërkesës për dorëheqje/përfundimin të prokurorit nga çështja.”

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nga 18 (tetëmbëdhjetë) praktika, 16 (gjashtëmbëdhjetë) prej tyre janë me deklarim të prokurorit për heqje dorë, të cilat janë pranuar në çdo rast, ndërsa 2 (dy) praktika janë me kërkesë të palës (një nga personi nën hetim dhe një nga kallëzuesja), të cilat edhe këto janë pranuar nga drejtuesi i prokurorisë.
- Në lidhje me procedurën e zëvendësimit të prokurorit që ndiqet në këtë prokurori rezulton se kërkesat e palëve protokollohen, ndërsa deklarimet e prokurorit i paraqiten drejtuesit të prokurorisë. Në rastin e kërkesës së palës rezulton të jetë marrë edhe mendimi i prokurorit në

formën e dhënies së pëlqimit për zëvendësim. Mënyra e caktimit të prokurorit të ri rezulton të jetë me short, elektronik ose manual. Në 2 (dy) raste caktimi i prokurorit është bërë drejtpërdrejt në vendim ku drejtuesi ka ngarkuar veten e tij me hetimin pas pranimi të kërkesës së personit nën hetim dhe pranimi të deklarimit për heqje dorë të prokurorit në rastin tjetër. Në rastet e deklarimeve për heqje dorë të prokurorëve vendimi i drejtuesit bazohet në nenin 26 të K. PR. Penale.

- Sa i takon numrit të deklarimeve për heqje dorë për secilin prokuror rezulton se:

Nr.	Prokurori	Numri i kërkesave për heqje dorë
1	A. Xhaferaj	1
2	E. Murataj	1
3	E. Shqarri	4
4	A. Anxhaku	1
5	M. Peza	7
6	F. Çela	2

- Arsytet e zëvendësimit të prokurorëve paraqiten bazuar në nenin 16 dhe 17, pikat c), ç) dhe ë) të K. Pr. Penale.
- lidhjes së gjinisë në 1(një) rast;
 - lidhje familjare 5 (pesë) raste;
 - shfaqje mendimi mbi objektin e procedimit 2(dy) raste;
 - mosmarrëveshje ndërmjet prokurorit, me të pandehurin ose njërën prej palëve private 2(dy) raste;
 - shkaqe të ndryshme të cilat janë konsideruar të rëndësishme për njëanshmërinë e prokurorit në 8(tetë) raste;

III. Gjetjet e inspektimit

Referuar analizimit të të dhënave të grumbulluara nga ky inspektim në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, rezulton se dokumentacioni për secilën praktikë zëvendësimi është i plotë, që do të thotë se në ndryshim nga konstatimet në inspektimet e mëparshme për këtë temë, nuk ka mungesa aktesh të procedurës së zëvendësimit të prokurorit (p.sh, deklarimi i prokurorit për heqje dorë ose vendimi i drejtuesit, dokumentimi i shortit për caktimin e prokurorit të ri, kërkesa e palës, informacioni i prokurorit kur i kërkohet mendim për dhënie/mosdhënie pëlqim). Ky fakt përveçse i shërben transparencës tregon se në prokurori janë reflektuar gjetjet e mëparshme në lidhje me këtë konstatim, konkretisht dhe në prokuroritë e inspektuara Dibër, Durrës dhe Vlorë. Në ndryshim nga sa aplikohet nga drejtuesi i prokurorisë Dibër dhe në prokurorinë Vlorë, në rastin e kërkesës së një pale për zëvendësim të prokurorit, në zyrën e prokurorisë Durrës nuk rezulton të kërkohet mendim nga prokurori për të cilin kërkohet zëvendësimi.

Në lidhje me përcjelljen e një numri të pasaktë të zëvendësimeve, të cilat vinin nga fakti se praktikat duheshin kërkuar nëpër dosjet e procedimeve penale, ndërkohë që rekomandimi nga inspektimet e mëparshme ishte që praktika e plotë e zëvendësimit të prokurorit të ruhet në aktet e drejtuesit dhe regjistër elektronik pa qenë nevoja të kërkohej çdo fashikull penal nga prokurori ose arkiva, për këtë vit inspektimi kjo problematikë rezultoi se është eliminuar.

Në praktikën e zëvendësimit të prokurorit edhe pse pretendohet se deklaratimet apo vendimet e drejtuesit përcillen nëpërmjet regjistrimit në librin e qarkullimit të brendshëm ose protokollohen, prej tyre nuk dokumentohet ky fakt nga regjistri ose nga vetë aktet. Nga katër praktikën e dërguara nga Prokuroria Dibër rezultoi se dy kërkesat e prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk janë të protokolluara/regjistruara. Në praktikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Vlorë rezultoi se, kërkesat e prokurorëve dhe vendimet e drejtuesit nuk rezultojnë të protokolluara/regjistruara.

Duke iu referuar datës së akteve të prokurorit dhe drejtuesit të prokurorisë, si dhe kërkesave të palëve, rezultoi se rastet e zëvendësimit të prokurorit janë trajtuar duke filluar nga brenda ditës deri maksimalisht në shtatë ditë kalendarike. Nga dokumentacioni i përcjellë nga zyrat e prokurorisë Dibër, Durrës dhe Vlorë, është konstatuar edhe 1(një) rast kur zëvendësimi i prokurorit është bërë me vonesë (2 muaj e 10 ditë) nga regjistrimi i kërkesës së palës (nr. 1754 prot., datë 09.10.2024 e shtetases D.Sh) për përjashtimin e prokurores nga hetimi i kallëzimit, bazuar në nenin 15 dhe 27 të K.Pr.Penale, në lidhje me të cilën prokurori përkatës ka shprehur mendimin e tij për dhënie/mosdhënie pëlqimi me deklaratën e datës 18.12.2024, kohë në të cilën ka dalë me vendim edhe drejtuesi i prokurorisë, që ka vendosur pranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit dhe hedhjen në short të procedimit nr. 876 të vitit 2024.

Në disa nga praktikën për zëvendësimin e prokurorit caktimi i prokurorit zëvendësues është bërë pa short, drejtpërdrejt me vendim të drejtuesit të prokurorisë. Në Prokurorinë Dibër kjo ka ndodhur në 2 raste, ku njëri prej tyre është material që i ka kaluar prokurorit të vetëm për hetimin e grupveprave penale për të mitur i caktuar me urdhrin nr. 43, datë 11.09.2023 të drejtuesit të prokurorisë në cilësinë e prokurorit për ndjekjen e grupveprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, ndërsa në praktikën tjetër pas pranimin të deklaratimit për heqje dorë të prokurorit të mëparshëm është caktuar prokurori i ri pa dhënë ndonjë arsyetim për caktimin e këtij prokurori pa short.

Në Prokurorinë Durrës është caktuar prokurori i mëparshëm i dosjes (nr.2010/2022) i kthyer në detyrë pas disa muaj raporti shëndetësor me arsyetimin e drejtuesit se meqënëse nga ana e prokurorit nuk janë kryer veprime hetimore dhe prokurorja që ka hetuar procedimin nga viti 2022 është rikthyer në detyrë është me vend zëvendësimi i prokurorit aktual në prokurorinë e mëparshëm. Edhe nga prokurori që ka kërkuar zëvendësimin është paraqitur si arsye fakti se hetimet janë komplekse dhe nga ana e tij nuk janë kryer veprime hetimore. Edhe në rastin

tjetër procedimi penal (nr.690/2018) i është kthyer të njëjtit prokuror të rikthyer në detyrë pas përfundimit të raportit shëndetësor, meqenëse nga ana e prokurores aktuale nuk ishte kryer asnjë veprim pasi pritej sjellja e dosjes origjinale nga Gjykata e Lartë Tiranë.

Në Prokurorinë Vlorë në 2 (dy) raste drejtuesi ka caktuar veten e tij me hetimin e çështjes, pas pranimi të kërkesës së personit nën hetim (një rast) dhe pranimi të deklarimit të prokurorit për heqje dorë (rasti tjetër), ku në të dy këto praktika, në vendimet e zëvendësimit nuk jepen arsye mbi caktimin pa short të drejtuesit të prokurorisë si prokuror i çështjes; në 2 raste duke iu caktuar prokurorit të gatshëm i cili ka marrë pjesë në kryerjen e veprimeve të para hetimore në kohën e ndodhjes së ngjarjes, pasi materiali i referuar ishte shortuar tek një prokuror tjetër. Në të dy këto praktika arsyetimi i drejtuesit bazohet në urdhrin nr. 14, datë 14.11.2023 të drejtuesit të prokurorisë *“Për shërbimin e gatishmërisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”*, neni 2, pika 3, e cila parashikon: *“Prokurori i gatshëm si rregull do të ndjekë/zgjidhë deri në fund rastet e paraqitur, referimet dhe kallëzimet që kërkojnë veprime të menjëhershme gjatë periudhës së tij të gadishmërisë....”*; në 1 rast pas pranimi të deklarimit për heqje dorë procedimi i është caktuar pa short pa ndonjë shkak një prej prokurorëve të seksionit për hetimin e krimit ekonomik, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe hetimit pasuror; dhe në një rast brenda seksionit për të mitur duke ju caktuar pa short njërit prej prokurorëve të këtij seksioni.

IV. Konkluzione

Kushtetuta (neni 148) përcakton Prokurorinë si organ të pavarur që respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve në hetime dhe ndjekje penale. Paanshmëria është një parim themelor, i cili nënkupton se prokurorët duhet të veprojnë pa ndikime të jashtme ose personale, duke u bazuar vetëm në ligj dhe prova e megjithatë ajo mbetet sfidë kryesore. Ligji procedural penal për të garantuar paanshmërinë e prokurorit dhe efikasitetin e hetimit parashikon rastet kur prokurori është i detyruar të heqë dorë nga hetimet e çështjes konkrete, si dhe ato kur ai zëvendësohet nga drejtuesi i prokurorisë. Nga ana tjetër në funksion të llogaridhënies shkelja e parimit të paanshmërisë e ngarkon prokurorin me përgjegjësi disiplinore sipas nenit 102/1, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016.

Në funksion të inspektimit u analizuan 29 praktika të zëvendësimit të prokurorit në Prokuroritë Dibër, Durrës dhe Vlorë, si dhe u shqyrtuan edhe rastet e tjera të zëvendësimit të prokurorit, si ato për shkak të kalimit të materialit prokurorit ose seksionit kompetent; leje lindje, arsye shëndetësore, rikthimit të materialit tek prokurori i gatshëm, ashtu dhe për shkak të transferimeve/pezullimit/shkarkimit të prokurorit. Nga praktikatat e analizuara rezulton se zëvendësimi i prokurorit kryesisht ndodh kur deklarohet nga prokurori, në dallim të rasteve kur vjen si kërkesë e palëve. Në rastet e mësipërme deklarimet e prokurorit për heqje dorë (24 deklarime) janë pranuar të gjitha, ndërsa nga 5 praktika me kërkesë të palëve (3-persona nën hetim/i pandehur dhe 2-kallëzues), 3 (tre) janë pranuar dhe 2 (dy) janë mospranuar.

Nga prokuroritë në inspektim evidentohet se është ndjekur procedura për zëvendësimin e prokurorit si mbi bazë deklarimi të tij për heqje dorë, ashtu dhe mbi bazë kërkesë nga palët ose subjektet e tjera të procedimit penal për zëvendësimin e prokurorit. Deklarimet e prokurorëve i paraqiten drejtuesit të prokurorisë drejtpërdrejt, ndërsa kërkesat e palëve nëpërmjet protokollimit të tyre. Pas shqyrtimit nga drejtuesi, vendimi i tij i komunikohet prokurorëve dhe/ose palës që ka bërë kërkesën dhe procedohet me caktimin e prokurorit të ri me short.

Megjithëse ligji nuk përcakton ndonjë afat për zëvendësimin e prokurorit, rezulton se nga momenti i deklarimit të prokurorit për heqje dorë ose protokollimit të kërkesës së palës deri në përzgjedhjen e prokurorit tjetër, kjo procedurë me përjashtim të një rasti është realizuar pa vonesa.

Nga praktikat e këtij viti mbi zëvendësimin e prokurorëve rezulton se deklarimet e prokurorëve për heqje dorë janë mbështetur në shkaqet e parashikuara në ligj dhe në lidhje me to është vendosur zëvendësimi i prokurorit. Në Prokurorinë Dibër ato i referohen bazës së duhur ligjore, nenit 26 në lidhje me nenin 17 të K. Pr. Penale, në Prokurorinë Durrës dhe Vlorë është vendosur në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale. Gjithashtu zëvendësimi i prokurorëve ka ndodhur edhe për shkaqe të parashikuara në ligjin nr. 97/2016 siç janë shkaqe shëndetësore, leje lindje, por edhe shkaqe të tjera (rikthimi në detyrë i prokurorit që ka patur më parë në ndjekje procedimin, procesi i rivlerësimit etj). Deklarimet e prokurorit dhe në disa raste edhe vendimet e drejtuesit të prokurorisë, përmbajnë një arsyetim të shkurtër mbi pranimin e shkakut për të cilin është hequr dorë ose është paraqitur kërkesa për zëvendësim. Në disa raste të konstatuara në Prokurorinë Durrës, zëvendësimi i prokurorit ka patur arsye të tjera që nuk parashikohen në ligj.

Përsa i përket shkaqeve, zëvendësimi i prokurorëve ka ardhur si shkak i pretendimeve të njëanësisë, referuar nenit 17/1 i K. Pr. Penale, kryesisht gërma ë) *“kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie”*, të cilat mund të jenë ato që krijojnë një dyshim të arsyeshëm në paanshmërinë e prokurorit. Arsyet e rëndësishme të njëanshmërisë nuk janë të përcaktuara në mënyrë shteruese në ligj, por në praktikë vlerësohen rast pas rasti nga prokurorët dhe drejtuesi i prokurorisë. Gjithashtu sipas gërmës c) *“kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit”*, si dhe ç) *“kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërën prej palëve private”*, shkak i cili ndan dy qëndrime, duke u interpretuar si mosmarrëveshje rastet kur pala ka paraqitur kallëzim ndaj prokurorit që heton/përfaqëson çështjen, si dhe rasti kur kallëzimi i palës ndaj prokurorit është trajtuar jo si mosmarrëveshje, por si shkak i rëndësishëm njëanshmërie. Në këtë kontekst do të ishte e nevojshme të unifikohet një qëndrim sidomos kur nga drejtuesit e prokurorive mund të merren vendime të ndryshme pranimi dhe mospranimi me bazë këtë pretendim. Në 6 raste në prokurorinë Vlorë shkak i zëvendësimit

ka qenë për kushte papajtueshmërie për shkak lidhje familjare, gjinie ose krushqie, të parashikuara nga neni 16 i K. Pr. Penale.

Në rastet e pranura të zëvendësimit rezultuan caktime të prokurorit të ri pa short (elektronik ose manual), praktikë e cila nuk është në përputhje me udhëzimin nr. 3, datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm *“Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”*, kreu IV ku parashikohet se: *“Kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do ti caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë, mban parasysh një trajtim të njëjtë mes prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit në seksionin përkatës”*. Por, edhe pse ka ndodhur në vendimet e drejtuesve të prokurorisë Dibër dhe Vlorë, nuk jepen arsye përse prokurorët janë caktuar pa short, referuar kompetencave të drejtuesit të prokurorisë të parashikuara në nenin 42 të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, ku ndër të tjera, në pikën 2, gërma “c” është parashikuar se *“organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente,”* dhe Udhëzimin nr. 03, datë 29.12.2016 *“Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”*, ku në këtë udhëzim, në kreun III, janë parashikuar edhe rastet e përjashtimit të një prokurori nga shorti.

Në vitin 2024 nuk ka pasur raste të zëvendësimit të prokurorit pa pëlqimin e tij sipas nenit 27 të K. Pr. Penale dhe as ankime të prokurorit ndaj vendimeve të drejtuesit, pasi në të gjitha rastet deklarimet e prokurorëve për heqje dorë janë pranuar. Kjo dispozitë rezulton se është aplikuar në vendimet e zëvendësimit kur shkaqet janë paraqitur për arsye shëndetësore, leje lindje, në referim të nenit 49/2 të ligjit nr. 97/2016; kur shkaqet janë paraqitur për arsye të shkarkimit nga detyra ose transferimit të prokurorit.

V. Rekomandime

Raporti i inspektimit t'i njoftohet prokurorive të inspektuara në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese, Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me qëllim njohjen e problematikave lidhur me praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.

- Nga drejtuesit e prokurorive të trajtohen me përparësi procedurat e zëvendësimit të prokurorit për të evituar vonesat për kalimin/moskalimin e çështjes nga prokurori i zëvendësuar tek prokurori zëvendësues. Në funksion të efikasitetit të hetimit të konsiderohet sanksionimi me afate i procedurës së zëvendësimit të prokurorit.
- Në rastet e caktimit të prokurorit të ri pa short, të jepen arsye të justifikuara në vendimet e drejtuesve të prokurorisë, duke parashtruar rrethana konkrete nëse prokurorët e tjerë janë përjashtuar nga shorti, nëse është prokurori i vetëm i ngarkuar me atë grup veprash, apo për arsye të tjera pse është disponuar duke përjashtuar çështjen nga shorti.

Për Prokurorinë e Përgjithshme:

- Të nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm një akt nënligjor lidhur me afatin e vendimmarrjes, si dhe unifikimin e një praktike lidhur me veprimet administrative për regjistrimin e deklarimeve për heqje dorë nga prokurori apo kërkesave të palëve për heqjen/zëvendësimin e prokurorit.

Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

- Në lidhje me gjetjet në prokurorinë Vlorë, të 2(dy) rasteve për caktimin pa short të drejtuesit të prokurorisë si prokuror i çështjes, *(pas pranimit të deklarimit të një prokurori për heqjen dorë dhe kërkesës së një personi nën hetim për zëvendësimin e një prokurori)* vlerësohet verifikimi i të dhënave për fakte që nëse provohen mund të përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar ligji nr. 96/2026, i ndryshuar.
- Referuar parashikimeve në nenin 102 pika 1 gërmat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, mbi shkeljet disiplinore të magjistratit në rastet e mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë/paraqitjes së kërkesës për heqje dorë nga procedimi jo në përputhje me ligjin, të shtohet si pikë e veçantë në raportimet periodike të zyrave të prokurorive pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë edhe të dhënat mbi rastet kur kërkesa e prokurorit për heqje dorë është rrëzuar me vendim të drejtuesit të prokurorisë (për kërkesat e prokurorëve të prokurorive të shkallës së parë) ose me vendim drejtuesit të prokurorisë së Apelit, (për kërkesat e drejtuesve të prokurorive të shkallës së parë).
- Ndjekja në vijimësi e rekomandimeve të këtij inspektimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin vendimit nr. 14, datë 01.04.2025 “Për kryerjen e inspektimit tematik me objekt: *“Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë për periudhën 01.01.2024-31.12.2024” të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.*
2. Caktimin e periudhës nga data 15.02.2026 deri në datën 15.08.2026, si periudhë për

ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

3. Të njoftohen Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.

INSPEKTORËT

Lindita Ziguri



Julian Zonja

